



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:249803

Datë: 18.06.2021

Numri i dokumentit: 01900804

**Pkr.nr.101/2020**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** –Departamenti për krimet të rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Artan Sejrani- kryetar i trupit gjykues, Refki Piraj dhe Fidan Hoxha anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Shqipron Sedolli, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.Sh., nga fshati ....., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 parag. 4 lidhur me parag.1 e lidhur me veprën penale dhuna në familje nga nëmi 248 parag. 1 dhe 2 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të autorizuar të armëve nga neni 366 parag. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr. 2362/2019 të datës 11.11.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e Prokurorit të Shtetit Metush Biraj, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij av. A.B., nga Prizreni, me datë 02.06.2021 publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datën 18.06.2021 përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari:**

**M.Sh.**, nga i ati .....dhe e ëma ....., e lindur ....., i lindur më datën ....., në fshatin ....., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani e ka vendbanimin, i martuar, baba i 9 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, bukëpjekës, me nr. personal .....shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

#### **I.**

### **ËSHTË FAJTOR**

Se me datë 26.10.2019, në kohë të papërcaktuar, në fshatin ....., Komuna e Prizrenit, saktësisht në afërsi të kopshtit të shtëpisë së tij, i pandehuri në kundërshtim me Ligjin për armët Nr. 05/L-022, pa autorizim ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armën e llojit pushkë automatike “AK-47”, me nr. serik 01222-84, dhe pesëmbëdhjetë (15) fishekë, të gjitha këto të mbajtura pa pasur leje nga organi kompetent.

**Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 22, 43, 59, 71, nenit 366 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarin e:

## GJYKON

Me dënim me gjobë në lartësi prej **tetëqind (800) euro**, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.10.2019 deri më datën 27.11.2019 (30 ditë), i akuzuari dënimin me gjobë është e obliguar ta paguajë në afatin prej dy (2) muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguajë dënimin me gjobë apo pjesën e mbetur të saj, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzetë (20) Euro të gjobës do të llogaritet një (1) ditë burgim.

Nga i akuzuari konfiskohet një (1) pushkë automatike “AK-47”, me numër serik 012225-84, pesëmbëdhjetë (15) fishekë të kalibrit të panjohur, një (1) karikator, pas plotfuqishmërisë të njëjtat sende duhet të shkatërrohen.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) euro dhe për fondin e viktimave të krimit në shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**Në kuptim të nenit 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të KPP-së,**

## II. REFUZOHET AKUZA

Sepse me datën 26.10.2019, rreth orës 14:00, në fshatin ....., Komuna e Prizrenit, saktësisht në shtëpinë e përbashkët familjare, seriozisht e kanosë bashkëshorten e djalit të tij-dëmtuarën D.Sh., me fjalë, vepra apo gjeste se do ti shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit, në atë mënyrë pas një mosmarrëveshje familjare lidhur me stolit e arit-një qereklirë të cilën e dëmtuara ia kishte dhuruar vajzës së vëllaut të saj dhe për këtë nuk e ka njoftuar fare të pandehurin-vjehrrin e saj, pasi që i pandehuri e kupton që i mungon një stoli ari- qereklirë të dëmtuarës, të njëjtën e kanos me fjalët : **“ka me të vra ty dhe gjithë familjen tënde”**, më pas është nisur për në Gjakovë për të shkuar tek familja e të dëmtuarës për t'i sqaruar hesapet me të njëjtit, e ku para se të nisej i drejtohet të dëmtuarës me fjalët kërcënuese **“po shkoj me ta vra familjen tënde dhe kur të kthehem ka me të vra edhe ty”**, kështu që i pandehuri merr një armë të shkurtë dhe niset për në Gjakovë ku edhe arrestohet nga policia e Gjakovës, me ç’rast tek e dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e ankthit, frikës dhe pasigurisë për jetën e saj dhe familjes se saj.

**Me çka kishte për të kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me par.1 e lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 dhe 2 KPRK-së.**

**Për shkak se Prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.**

Shpenzimet e procedurës penale për këtë veprë penale bien në barrë të buxhetit të kësaj gjykate.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren – departamenti për krimet të rënda, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 2362/2019 të datës 11.11.2019, kundër të akuzuarit M.Sh., nga fshati ....., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 parag. 4 lidhur me parag.1 e lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 parag. 1 dhe 2 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të autorizuar të armëve nga neni 366 parag. 1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale e ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datën 02.06.2021.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pasi që i akuzuari M.Sh., , në bazë të kushteve të parapara me ligj ka pranuar fajësinë të veprës penale të armë mbajtjes pa leje, duke marrur parasysh që kemi edhe prova tjera që janë administruar në këtë gjykim, që e vërtetojnë këtë fakte, gjykatës i propozoj që i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, duke u marrur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese të cilat ndikojnë në marrjen dhe lartësinë e dënimit. Pasi që në bazë të deklaratës të dëmtuarës si dëshmitare D.Sh., dhe mbrojtjes të akuzuarit i cili mohon faktin e pretendimeve në aktakuzë se ka kryer vepër penale kanosje nga neni 181 parag. 4 e lidhur me parag. 1 dhe lidhur me veprën penale dhunë në familje, nga neni 248 parag. 1 dhe 2 të KP-së, në mungesë të provave heki dorë nga aktakuza ndaj të akuzuarit për veprën penale në fjalë. Gjykatës po ashtu i propozoj të akuzuarit të i shqiptohet edhe dënimi plotësues i marrjes së pushkës automatike AK-47 me 15 fishek dhe një karikator si mjet i kryerjes së veprës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.Sh., av. A.B., në fjalën përfundimtare deklaroi se pas administrimit të provave të shqyrtimit kryesor përkrahi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, lidhur me heqjen dorë të dispozitivit të parë të aktakuzës. Ndërsa sa i përket dispozitivit të II të kësaj aktakuze, ku i mbrojturi im M.Sh., ka poseduar armë pa leje, ne e kemi pranuar qysh në fillim të procedurës: Andaj lus gjykatën që gjatë matjes dhe lartësisë së dënimit t'ia shqipton një dënim sa më të butë, e them këtë me arsye sepse i mbrojturi im është i gjendjes së varfër ekonomike, hera e parë që bie ndesh me ligjin, ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë këso vepra penale, është mbajtës i familjes andaj një dënim më i butë ndikon në risocializimin e këtui mbrojturit tim.

I akuzuari M.Sh., në fjalën përfundimtare deklaroi se në tërësi e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar gjendjen faktike për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së: Se i akuzuari M.Sh., me datë 26.10.2019, në kohë të papërcaktuar, në fshatin ....., Komuna e Prizrenit, saktësisht në afërsi të kopshtit të shtëpisë së tij, i pandehuri në kundërshtim me Ligjin për armët Nr. 05/L-022, pa autorizim ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armën e llojit pushkë automatike “AK-47”, me nr. serik 01222-84, dhe pesëmbëdhjetë (15) fishekë, të gjitha këto të mbajtura pa pasur leje nga organi kompetent.

Gjykata gjendjen faktike sipas dispozitivit nën I të aktgjykimit e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, i cili pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 248 të KPP-së, pasi që i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe pas

konsultimeve me mbrojtësin e tij, gjithashtu pranimit i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime teknike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se me veprimet e të akuzuarit M.Sh., formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale-juridike të tij.

Gjykata për veprën penale kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me par.1 e lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 dhe 2 KPRK-së ka marrë aktgjykim refuzues pasi që Prokurori i Shtetit është tërhequr nga aktakuza për këtë vepër penale në përfundim të shqyrtim gjyqësor respektivisht në fjalën përfundimtare.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana renduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, andaj gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënimet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke menduar se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë parandalues si dhe i akuzuari të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës, gjykata e mori në kuptim të nenit 453 të KPP-së.

Vendimi mbi taksën gjyqësore, në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë në pajtim me nenin 39 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti për Krimet të Rënda  
Pkr.nr.101/2020 të datës 18.06.2021**

*B. Profesional  
Shqipron Sedolli*

**Kryetari i trupit gjykues,  
Artan Sejrani**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate